

**ELONA GJATA**

**RRETH TIPEVE FJALËFORMUESE TË NEOLOGJIZMAVE NË  
ROMANIN *DARKA E GABUAR* TË I. KADARESE**

Kadareja, është një ndër autorët që ka dhënë kontribut të mjaftë në fushën e letërsisë, dhe jo vetëm, por edhe në pasurimin e gjuhës shqipe.

Kontribut të mjaftë mbi huazimet, dialektizmat, frazeologjizmat dhe neologjizmat.

Pikërisht ne do të ndalemi në këtë të fundit, në studimin e neologjizmave të romani *Darka e gabuar*.

Neologjizmat<sup>1</sup> paraqesin një interes të veçantë studimi, sidomos për stilistikën, sepse vëmendjen e saj e tërheqin ato krijime që përfshihen në tekst, jo sepse mungonte fjala përkatëse për të emërtuar diçka, por sepse kërkohet të arrihet në një efekt shprehës.

Neologjizmat e Kadarese përbëjnë interes të veçantë, sepse nuk mbeten vetëm brenda kontekstit për të zbuluar stilin e autorit, por marrin një shtrirje të gjerë, duke u bërë pjesë e leksikut të shqipes.

1. Ishte apo s' ishte **grarrëmbyes** ky qytet, kjo nuk ishte vërtetuar kurrë. (f. 18)

2. ...të zbuste mërinë ndaj **brinjathyesit**. (f. 20)

3. **Kombëtaristët** s'ishin kundër... (f. 20)

4. ...vetë zonjat, me **këmishënatat** e mëndafshta... (f. 22)

5. ...kjo gjemë ngjante e **tjetërfortë**, ngaqë dukej si ndëshkim që pësonte gruaja. (f. 23)

6. ...një shpjegim lehtësues e **fajshpërndarës** si era, të gjithë u ndien të lehtësuar. (f. 26)

7. E kishte ruajtur, pra gëzimin, për ta nxjerrë befas në atë **messhtatori**. (f. 28)

9. .... hipur në dy **trirrotësha**, me mitraloza në duar... (f. 41)

10. Çdokush kishte pasur mënyrën e vet të **pengëtimit**. (f. 59)

11. ...por, këtë herë **zymtor** e dramatik... (f. 61)

12. ...për të mos acaruar **virtytomëdhenjtë** shqiptarë... (f. 77)

13. ...vinin, gjithashtu lajme **paqtuese**. (f. 79)

14. ...njëfarë ikjeje në larginë a një **hënëzim**, shenjate para të **zonjëzimit**. (f. 111)

15. Tek ai më i errëti, i **stërrërrëti**. (f. 175)

---

<sup>1</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 123.

16. ...po i shoqëronte nëpër **nënharkoren** e gjatë. (f. 174)

Neologjizmat stilistike në të shumtën e rasteve ndërtohen sipas modeleve prodhuese në gjuhë, ose duke u shmangur prej tyre. Kadare në këtë vepër mbetet partizan i modelit të shqipes, duke përdorur parashtesat dhe prapashtesat më prodhimtare të shqipes, gjithashtu dhe kompozitat.

Nëse do të nisemi nga mënyra e fjalëformimit të këtyre neologjizmave ato do të ndaheshin në kompozita, ku numërohen 8 shembuj prej tyre. Dhe jo pa qellim, pasi kompozimi<sup>2</sup>, pas ndajshimit, është mënyra më prodhimtare e formimit të fjalëve në shqipen e sotme. Por, gjithashtu, ashtu si kompozitat, një vend të rëndësishëm në këtë roman zënë edhe fjalët e prejardhura me para dhe prapashtesim, ku numërohen 11 shembuj prej tyre, forma më dominante është ajo me parashtesim.

Së pari le të ndalemi në analizën fjalëformuese të kompozitave.

**brinjathyesit** - brinjë + thyes (emër + emër prejfoljor i vepruesit) - i tipit leshpunues, fatrrëfyes etj.

**këmishënatat** - këmishë + natë (emër + emër çfarëdo) - i tipit vendbanim, vargmal, punëdore etj.

**e tjetërfortë** - tjetër + (i) fortë (përemër i pacaktuar + mbiemër) - tip që nuk gjen përdorim të dendur në gjuhën shqipe.

**fajshpërndarës** - faj + shpërndarës (emër + emër prejfoljor i vepruesit) - i tipit rrobaqepës, ujësjellës, gjellëbërës etj.

**trirrotësia** - tri + rrotë(sh) (numëror + emër) - i tipit katërkatësh, dykëmbësh.

**virtptomëdhentë** - virtyt + madh (emër + mbiemër) - i tipit buzëmadh, gushëkuq, qafëzezë etj.

**Messhtatori** - mes + shtator (emër + emër) - i tipit mesfushor, meshollë, mesgjuhor, mesditë etj.

Ndërsa analiza fjalëformuese e fjalëve të prejardhura do të ishte:

**Kombëtaristët** - kombëtar + ist - (për analogji mendoj se mund të shkojë me tipin militarist).

Prapashtesë<sup>3</sup> prodhimtare në gjuhën shqipe, me prejardhje të huaj. Me anë të saj formohen emra ithtarësh të një rryme ose doktrine, edhe emra mjeshtërish.

**pengëtim** - pengëto + im - (për analogji me tipin udhëtim etj.)

Një nga prapashtesat më të shpeshta të shqipes, më të cilën formohen emra veprimi që formohen prej foljesh<sup>4</sup>.

Prapashtesë prodhimtare, sidomos në gjuhën letrare.

**zymtor** - (i) zymt(ë) + or - për analogji me tipin leshtor etj.

<sup>2</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 70.

<sup>3</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 135.

<sup>4</sup> A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 491.

Prapashtesë mjaft prodhimtare në formimin e mbiemrave dhe përdorim të kufizuar te emrat. I njihet ngjyrimi poetik dhe ai libror<sup>5</sup>. Në rastin tonë, si edhe në formime të tjera të leksikut të Kadaresë, ajo ka ngjyrim poetik. Ngjyrimi libror, i njihet pasi është bërë prodhimtare në gjuhën e stileve të shkruara. E gjejmë edhe në veprimtarinë e Kadaresë.

**paqtuese** - paqto + ues - (për analogji me tipin mësues, punues etj.)

Prapashtesë e dalë nga dialekti verior, me të cilën formohen emra vepruesish, por edhe një sërë mbiemrash.

**hënëzim** - hënëzo + im - për analogji me tipin pyllëzim etj.

**zonjëzim** - zonjëzo + im - (e njëta gjë si me fjalën hënëzim).

**nënharkoren** - nën + harkore (parashtesë + emër prejfoljor) - e tipit nënlëkurë, nënstacion etj.

Parashtesë<sup>6</sup> mjaft prodhimtare në gjuhën shqipe.

Këtë parashtesë<sup>7</sup> e gjejmë në disa emra që tregojnë më të shumtën vegla. Kjo parashtesë për analogji rrjedh nga gjuhët e huaja me të cilën janë formuar një varg fjalësh edhe në gjuhën shqipe. Kjo parashtesë tregon tek emrat një objekt që gjendet nën një tjetër.

Shkon krahas emrave nëndetëse, nëntokë, nënfletë etj.

**i stërrërrëti** - stër + i errët (parashtesë + mbiemër) - i tipit i stërmadh, i stërlavdishëm etj.

Parashtesa stër<sup>8</sup> përdoret e në fjalët e prejardhura, e cila tregon diçka që bëhet me tepri, ka madhësi të jashtëzakonshme ose është jashtë asaj që duhet, siç është në rastin tonë, duke luajtur rol ngjyruës, që shërben për përforcimin shprehës<sup>9</sup>.

Një parashtesë mjaft produktive sipas A. Xhuvanit, që gjendet në disa fjalë të gjuhës shqipe, si emra, folje, por edhe mbiemra, si i stërgjatë, etj.

Fjalët e mësipërme nuk hasen as në fjalorin e 1980, as në fjalorin e 2002, as në të 2006-ës. Kështu, Kadareja, si fjalëkrijues i jep leksikut një pasuri të gjallë, duke u konsideruar, dhe me të drejtë, si stilist i gjuhës shqipe.

Ajo çka na bie tjetër në sy në këtë vepër është përdorimi i disa fjalëve, që edhe pse gjenden në fjalor, ato nuk kanë përdorim të gjerë në ligjërimin e përditshëm, por Kadareja i risjell me vlera semantike. Ndër to janë përdorur: *do të përkiteshin, shemërim, gurane, zhurmëria, rrugëtoja, darkëtarët, (ishte) zymtuar, ndezullia, bjerraditës, i thantë, dritësim, trillane, larginë, zhdrivillim, sipëraninë*, fjalë të gjendura vetëm në fjalorin e 2006, mendoj se mund të jenë fjalë të Kadaresë, sepse janë përdorur edhe më parë prej tij etj.

<sup>5</sup> E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f. 33.

<sup>6</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 61.

<sup>7</sup> A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë, 1980, f. 390.

<sup>8</sup> *Fjalori i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2006, f. 983.

<sup>9</sup> E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f. 33.

Kadareja, radhitet krahas autorëve rilindas, Poradecit, Nolit etj. që dhanë një kontribut të veçantë në zhdjervillësimin e gjuhës shqipe dhe pastërtinë e saj<sup>10</sup>.

Në secilën e tapë, neologjizmat janë shfaqje e kulturës poetike të kohës, e prirjes në lëvrimin poetik të gjuhës<sup>11</sup>.

Por, gjithashtu neologjizmat nuk vijnë vetëm si kërkesa leksikore, por edhe për nevoja shprehëse të tërthorta ose të jashtme të ligjërit<sup>12</sup>.

Kadare ka meritën e madhe duke u radhitur ndër të parët shkrimtarë që ka sjellë numrin më të madh të neologjizmave në gjuhën shqipe<sup>13</sup>.

Me anë të tyre autori synon të ngjallë përshtypje dhe deformim të modeleve të fjalëformimit si dukuri e gjallë e gjuhës si dhe një turbullim të anës së brendshme psikike<sup>14</sup>. Gjithashtu ai përpiqet të krijojë edhe situata irrealë e surrealistë, me anë të disa prej neologjizmave të tij.

Vepra e tij ka sintagmatikë dhe paradigmaticë, leksiku i tij përçon kulturë, histori, etnosociologji etj.

Vetë titulli i romanit *Darka e Gabuar*, të çon menjëherë në bibël, *Darka e Fundit*.

Meritë tjetër e Kadaresë qëndron në faktin se neologjizmat e tij janë të gjalla dhe jo artificiale, siç ndodhi me disa autorë të Rilindjes, formimet e të cilëve mbeten krejtësisht artificiale.

Por, ajo që ngelet për t'u diskutuar është se a do të jenë pjesë e fjalorit të ardhshëm të gjuhës shqipe këto fjalë?

Kjo është një çështje që i takon vendit që këto fjalë do të gjejnë në përdorim.

---

<sup>10</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 124.

<sup>11</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 124.

<sup>12</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 124.

<sup>13</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 125.

<sup>14</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 125.